

**Fjalimi i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
znj. Arta Rama-Hajrizi, në 10-vjetorin e themelimit të Gjykatës**

Më lejoni që fillimisht t'ju uroj mirëseardhje në ceremoninë e kremtimit të Vitit të 10-të Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Për të festuar këtë përvjetor jubilar të Gjykatës tonë, përkrah përfaqësuesve institucional dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë në vend, së bashku me ne sonte janë edhe delegacionet nga gjykatat kushtetuese të: Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së veriut, Kroacisë, Turqisë, Çekisë, Portugalisë, Maltës dhe Luksemburgut. Me ne sonte është edhe përfaqësuesja e Irlandës në Komisionin e Venecias, profesoresha dhe juristja e të drejtave të njeriut me renome ndërkombëtare, znj. Grainne McMorro, si dhe drejtori për çështje ndërkombëtare i Shoqatës së Federalistëve Amerikan për Studime të Ligjit dhe të Politikave Publike, z. Jim Kelly.

Shfrytëzoj rastin që t'ju falënderoj të gjithëve nga zemra për prezencën tuaj në këtë ngjarje, e cila të nesërmen do të shënohet edhe me mbajtjen e Konferencës ndërkombëtare në temën: *“Sigurimi i sundimit të ligjit dhe i të drejtave të njeriut përmes mekanizmave të drejtësisë kushtetuese: Sfidat e Shekullit 21”*.

Të nderuar mysafirë,

Viti i kaluar ishte një vit i veçantë për të gjithë qytetarët e vendit, ngase të gjithë së bashku kremtuam jubileun e 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe të hartimit të Kushtetutës së Kosovës. Por, viti 2019 është një vit i veçantë po ashtu, sepse shënon dekadën e parë të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në kohën kur u themelua Gjykata para dhjetë vjetësh, gjyqtarët e saj, në mungesë të kushteve themelore për punë, mbajtën seancat e para shqyrtuese në hapësirat e Kuvendit të Kosovës dhe të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Mirëpo, falë punës dhe vullnetit të gjyqtarëve kushtetues, e veçanërisht të gjyqtarëve ndërkombëtar që sollën përvojën profesionale, jo vetëm që kontribuan në konsolidimin institucional të Gjykatës, por ndihmuan edhe në vendosjen e standardeve evropiane të vendimmarrjes, të bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilat edhe u vendosën themelet e gjyqësisë kushtetuese të Kosovës së pavarur. Në këtë aspekt, një faktor plotësues i punës tonë gjithmonë ka qenë edhe mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë, për çka ju mbetemi përjetësisht falënderues.

Zonja e zotërinj,

Përderisa kushtetutat çdoherë janë konceptuar si kornizë e qeverisjes së një vendi, themelimi i gjykatave kushtetuese është vlerësuar si një lloj katalizatori i transformimit të shoqërive në shtete demokratike dhe të sundimit të ligjit, duke u bazuar në mbikëqyrjen e pushtetit politik.

Janë një sërë vendimesh të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që dëshmojnë për rolin kyç që ajo ka luajtur në përforcimin e parimit të sundimit të ligjit dhe në zhvillimin e demokracisë gjatë dekadës së fundit në Republikën e Kosovës.

Përballja me kërkesa komplekse dhe mjaft delikate për nga përmbajtja e tyre, e shpesh edhe me rëndësi jetike për organizimin e jetës institucionale dhe politike në vend, ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme për Gjykatën dhe për të gjithë gjyqtarët e saj.

Mbi këto raste dhe mbi këto vendime, që për nga natyra e tyre variojnë nga shqyrtimi i çështjeve të konfliktit të kompetencave midis pushteteve, e deri tek çështjet e pavarësisë së institucioneve dhe të mohimit të së drejtës në gjykim të paanshëm, qëndron e shkruar edhe vet historia e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Në përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes, por edhe për t'iu përmbajtur me rigorozitet rolit dhe përgjegjësisë së mveshur nga Kushtetuta, viteve të fundit Gjykata ka arritur të rishqyrtoj, ndryshoj dhe konsolidoj praktikën e saj përkitazi me parashtresat që në vete ngërthejnë çështje të ndryshme politike dhe hipotetike kushtetuese, duke i refuzuar si të tilla.

Gjykata, në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore, duke aplikuar kuptimin e zgjeruar të nocionit "çështje kushtetuese", kishte shqyrtuar kërkesa që nuk përfshihen shprehimisht në kufijtë e juridiksionit të saj dhe për këtë ka vendosur nga rasti në rast. Qasja e mëhershme e Gjykatës duhet kuptuar në frymën e vendosjes të themeleve të gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata të përfshihet në interpretime të disa neneve specifike të Kushtetutës me rëndësi thelbësore për procesin e shtetformimit.

Tani, me kalimin e një dekade të Gjykatës Kushtetuese, përgjigjet në pyetjet të cilat nuk ndërliken me juridiksionin e Gjykatës por me çështje hipotetike jashtë kompetencave të saj, nuk janë të nevojshme. Kjo nuk është bërë për t'i ikur përgjegjësisë apo nga hezitimi për të adresuar këto situata, por për të ushtruar rolin mbikëqyrës që këtij institucioni ia ka mveshur Kushtetuta, për të zgjidhur çështjet kontradiktore në kuadër të juridiksionit të vet nëpërmjet vendimeve të mirëfillta dhe jo duke ofruar përgjigje ose këshilla juridike për institucionet e tjera.

Gjykata ka sqaruar rolin dhe përgjegjësitë e saj kushtetuese në raport me autoritetet e tjera publike që mund t'i drejtohen asaj dhe mënyrën se si ato mund t'i drejtohen

Gjykatës. Konsideroj se kjo qartësi do të jetë në shërbim të mirë të dekadave të ardhshme të mbrojtjes së kushtetutshmërisë në Republikën e Kosovës. Kësisoj, është fuqizuar edhe roli parësor i Gjykatës Kushtetuese si gardian përfundimtar i Kushtetutës dhe i mbrojtjes së saj nga të gjitha veprimet e autoriteteve publike.

Përderisa vendimmarrja dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë vlerësuar pozitivisht edhe në Raportet e Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian, dhe ajo që duhet potencuar në vazhdimësi është se zbatimi i këtyre vendimeve është obligim kushtetues dhe përgjegjësi e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese së fundmi ka funksionalizuar një trup të brendshëm për monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të saj, e cila deri më tash ka informuar në disa raste Kryeprokurorin e Shtetit për moszbatim të vendimeve, si masë e fundit kjo me të cilën disponon Gjykata për të siguruar implementimin e vendimeve të veta. Institucionet e Republikës së Kosovës, e në veçanti gjyqësori dhe Kryeprokurori i Shtetit, duhet të ofrojnë mbështetjen e tyre të pa kompromis për zbatimin e çdo vendimi të Gjykatës Kushtetuese, sepse vetëm kështu mund të garantojmë forcimin e sundimit të ligjit në vend.

Zonja e zotërinj,

Shikuar në retrospektivë, Gjykata Kushtetuese ka shënuar një progres të konsiderueshëm për një kohë jo edhe aq të gjatë.

Para dhjetë vjetësh nuk kishim as gjykatore. Por, sot kemi sistemin më modern elektronik për menaxhimin e lëndëve dhe ueb-faqen më të avancuar, e cila mundëson abonimin e drejtpërdrejt në të gjitha vendimet dhe publikimet e Gjykatës.

Para dhjetë vjetësh, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese praktikisht nuk ekzistonte. Por, sot kemi mbi 1 400 vendime të publikuara, e ku disa prej tyre publikohen çdo vit edhe në Buletinet periodik të Komisionit të Venecias.

Vetëm dhjetë vjet më herët, ne nuk kishim marrëdhënie bashkëpunimi me asnjë gjykatë kushtetuese të vendeve të rajonit apo ato evropiane. Por, sot kemi të nënshkruara memorandume mirëkuptimi me shumë prej tyre, kemi bashkëpunim të shkëlqyer me Komisionin e Venecias, jemi anëtar me të drejta të plota të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese.

Megjithëse ndihemi krenar me atë që kemi arritur deri tani, e gjithë kjo na shërben edhe si nxitje për të reflektuar dhe për të punuar më shumë drejt sukseseve të reja.

Të nderuar mysafirë,

Gjatë këtyre viteve, jo rrallë Gjykata është bërë pjesë e debateve politike, e i është nënshtruar akuzave e deklaratave të padrejta dhe të pasakta për vendimmarrjen tonë. Thënë këtë dhe duke parasysh që Gjykata fuqishëm përkrah dhe mbron lirinë e shprehjes si një liri themelore e garantuar në Kushtetutën tonë, unë shpresoj fuqishëm se, teksa po hyjmë në dekadën e dytë të punës, debatet rreth Gjykatës dhe vendimeve të saj do të riorientohen më shumë rreth diskutimit të arsytimit profesional dhe të argumentuara nga Gjykata, në mënyrë që qytetarët të informohen drejtë dhe të vazhdojnë të besojnë në pavarësinë e gjyqësisë kushtetuese të Kosovës. Kjo është edhe një nga vlerat më të çmuara të çdo shoqërie demokratike dhe për konsolidimin e mëtejshëm të saj kemi përgjegjësi të gjithë.

Sot e them me krenari se, për dallim nga vitet e para pas themelimit, Gjykata Kushtetuese tani është dukshëm më e përgatitur për atë që do na e sjell e ardhmja. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për sfidat nëpër të cilat po kalon aktualisht vendi ynë, si në aspektin e integriteteve euro-atlantike, e po ashtu edhe në procesin e dialogut drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Republikën e Serbisë.

Unë ju siguroj se në të gjitha këto procese, Gjykata Kushtetuese do të mbetet gjithmonë në krye të detyrës dhe e gatshme të jetësojë juridiksionin e saj. Gjykata Kushtetuese do të mbetet garantues i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe vlerave themelore të mishëruara në Kushtetutën tonë, me integritet profesional dhe pavarësi të plotë vendimmarrëse.

Në këtë jubile të rëndësishëm për të gjithë ne, në fund dëshiroj të shpreh konsideratën dhe mirënjohjen time edhe për gjyqtarët aktual dhe gjyqtarët e gjeneratës së parë të Gjykatës Kushtetuese, për Sekretarin e përgjithshëm të Gjykatës, Këshilltarin e parë dhe të gjithë këshilltarët kushtetues, për stafin e Kabinetit tim, si dhe zyrtarët e tjerë të Sekretarisë, pa kontributin e të cilëve sukseset e gjyqësisë kushtetuese në Kosovë do të ishin dukshëm më të zbehta.

Ju falënderoj edhe njëherë nga zemra për pjesëmarrjen tuaj dhe urime 10-vjetori i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.